



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2238/5 prot.

Datë 19.08.2026

V E N D I M
Nr.1010/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Edvin Simo	Anëtar
Donika Daci	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.08.2026, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “PUBLIC ACCOUNTING SERVICE UNION AND TRUST” SHPK & “Eljona Hoxha” PF në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-89214-06-08-2026, me objekt: “Menaxhimi Financiar, Testi i Zhvlerësimit dhe IFRS9”, me fond limit 8,700,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 19-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “DELOITTE ALBANIA” SHPK me NIPT J62329003N dhe adresë Rruga “Muhedin Llagami”, Njësia Administrative nr.7, Kompleksi Delijorgji, Godina MD-Biznes, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë
Rruga “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** BOE “Public Accounting Service Union and Trust” SHPK me NIPT L21423032S & “Eljona Hoxha” PF me NIPT M12213005N dhe adresë Tiranë, Rruga “Themistokli Germenji”, Pallati Ambasador 1, Kati 1

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 08.06.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit *“E hapur, e thjeshtuar”*, me Nr. REF-89214-06-08-2026, me objekt: *“Menaxhimi Financiar, Testi i Zhvlerësimit dhe IFRS9”*, me fond limit 8,700,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

II.2. Në datën 19-06-2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 30.06.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “Public Accounting Service Union and Trust” SHPK & “Eljona Hoxha” PF 7,880,000 lekë pa tvsh kualifikuar
2. “Deloitte Albania” SHPK 8,600,000 lekë pa TVSH kualifikuar

II.4. Në datën 08.07.2026, në Sistemin e Prokurimit Elektronik autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak të procedurës së prokurimit.

II.5. Në datën 10.07.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2238/2026 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6950 e operatorit ekonomik “DELOITTE ALBANIA SH.P.K” SHPK për procedurën e prokurimit E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-89214-06-08-2026, me objekt: “Menaxhimi Financiar, Testi i Zhvlerësimit dhe IFRS9”, me fond limit 8,700,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 19-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “PUBLIC ACCOUNTING SERVICE UNION AND TRUST” SHPK & “Eljona Hoxha” PF.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2238/1 prot., datë 14.07.2026.

II.7. Me shkresën me nr. 3252/2 prot., datë 17.07.2026 me lëndë “Vendim për shqyrtimin e ankesës për procedurën e prokurimit me objekt: “Menaxhimi Financiar, Testi i Zhvlerësimit dhe IFRS9”, NR.REF-89214-06-08-2026”, protokolluar me tonën me nr. 2238/2 prot., datë 20.07.2026 autoriteti kontraktor ka dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “DELOITTE ALBANIA” SHPK nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuar në përputhje me nenin 113 të ligjit “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “DELOITTE ALBANIA” SHPK për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së BOE “PUBLIC ACCOUNTING SERVICE UNION AND TRUST” SHPK & “Eljona Hoxha” PF me arsyetimin si vijon: “[...] objekti i kësaj procedure përbën një shërbim me karakter të lartë teknik dhe të specializuar, i cili nuk kufizohet në ofrimin e shërbimeve të përgjithshme të kontabilitetit, auditimit apo konsulencës financiare, por kërkon njohuri të avancuara dhe përvojë të provuar në zbatimin praktik dhe realizimin e shërbimeve me kompleksitet teknik të krahasueshëm me objektin e kësaj procedure. të vlerësimin fillestar të huave me vlerën e drejtë; llogaritjen e kostos së amortizuar sipas metodës së interesit efektiv; matjen e vlerës së drejtë të huave sipas kërkesave të snrf; shërbimet objekt prokurimi përfshijnë, ndër të tjera, matjen fillestare të huave me vlerën e drejtë, matjen pasuese të tyre me kosto të amortizuar duke zbatuar metodën e normës efektive të interesit, si dhe përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare për qëllime të raportimit financiar. këto janë procese që kërkojnë ekspertizë të specializuar në modelimin financiar, në teknikat e vlerësimit të instrumenteve financiare dhe nuk mund të konsiderohen si pjesë e zakonshme e shërbimeve standarde të auditimit apo kontabilitetit. pikërisht për shkak të natyrës së veçantë dhe kompleksitetit teknik të objektit të kontratës, autoriteti kontraktor kishte detyrimin të kryente një verifikim të plotë, objektiv dhe të dokumentuar të përvojës së operatorit ekonomik të shpallur fitues paraprak, public Accounting service union & trust, me qëllim të konstatimit nëse ky operator ka realizuar më parë shërbime realisht të ngjashme me ato që kërkohen në këtë procedurë. nga dokumentacioni i bërë publik nuk rezulton në mënyrë të qartë dhe të verifikueshme se kontratat dhe referencat e paraqitura nga operatori ekonomik fitues paraprak përfshijnë konkretisht shërbime që lidhen me: matjen fillestare të huave me vlerën e drejtë; llogaritjen e kostos së amortizuar sipas metodës së normës efektive të interesit; përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare sipas kërkesave të ifrs 9; hartimin ose zbatimin e modeleve financiare për matjen e instrumenteve financiare; realizimin e shërbimeve me të njëjtën natyrë, kompleksitet teknik dhe nivel ekspertize si objekti i kësaj procedure. për rrjedhojë, nuk rezulton e provuar se përvoja e paraqitur nga operatori ekonomik fitues paraprak përmbush kërkesën e dokumenteve të tenderit për realizimin e shërbimeve të ngjashme . vetë ekzistenca e kontratave në fushën e auditimit, kontabilitetit apo konsulencës financiare nuk mjafton për të provuar përmbushjen e këtij kriteri, nëse nga përmbajtja e tyre nuk evidentohet se ato kanë përfshirë konkretisht aktivitetet teknike që përbëjnë objektin e kësaj procedure [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

b) *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

III.1.2. Në shtojcën 8 “Termat e referencës”, të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar termat e referencës si më poshtë vijon:

TERMAT E REFERENCËS

Menaxhimi Financiar, Testi i Zhvlerësimit dhe IFRS9

Vështrim i Përgjithshëm

Objektivi i kësaj konsulence është që të mundësojë KESH sh.a. të paraqesë Pasqyrat e saj Financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), siç publikohen nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB).

Në zbatim të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit, KESH sh.a. duhet të kontraktojë një vlerësues të pavarur ("Vlerësuesi") për të kryer testin e zhvlerësimit (Impairment Test) për Aktivet Afatgjata Materiale më datë 31 Dhjetor 2023, 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2025, për shkak të ndryshimeve të mundshme në flukset e ardhshme monetare, si dhe zbatimin e kërkesave të SNRF 9 - Instrumentet financiare, më datë 31 Dhjetor 2023, 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2025, me qellim raportimin financiar.

Të gjitha Aktivet Afatgjata Materiale të KESH sh.a., të cilat lidhen me hidrocentralet e Koman, Fierzë dhe Vau Dejës, duhet të testohen për zhvlerësim (Impairment Test) nga një konsulent i pavarur më 31 Dhjetor 2023, 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2025, për të përcaktuar vlerën e drejtë të aktiveve sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Gjithashtu, nga konsulenti duhet të bëhet aplikimi i SNRF 9 për instrumentet financiare, si dhe

rregullimet përkatëse në pasqyrat financiare të konsoliduara për datën 31.12.2023, 31.12.2024 dhe 31.12.2025.

Janë bërë rregullimet për vlerën e drejtë të huave me norma interesi të ndryshme nga norma e tregut, së bashku me llogaritjen e mëtejshme me kosto të amortizuar, duke përdorur normën e interesit efektiv dhe matjen e huave me vlerën e drejtë në momentin fillestar, si dhe njohjen e mëtejshme me koston e amortizuar, me qëllim raportimin financiar.

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

- Kryerja e testit të zhvlerësimit (Impairment Test) për Aktivet Afatgjata Materiale, bazuar në aftësinë e tyre për të gjeneruar flukse monetare, për qëllime të raportimit financiar, në përputhje me

SNRF-të.

- Vlerësimi i huave të dhëna dhe të marra me vlerën e drejtë në momentin fillestar për huatë e reja, llogaritja e koston së tyre të amortizuar, si dhe llogaritja e vlerës së drejtë në momentin e paraqitjes në pasqyrat financiare, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

- Vlerësim (analizim dhe implementim) për zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), aplikimi i të cilëve hyn në fuqi gjatë periudhës raportuese, që duhet reflektuar gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, si edhe aplikimi i SNRF 9

.....

III.1.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, BOE “PUBLIC ACCOUNTING SERVICE UNION AND TRUST” SHPK & “Eljona Hoxha” PF ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë për bashkim të përkohëshëm të operatorëve ekonomik lidhur ndërmjet operatorit ekonomik “Public Accounting Service Union and Trust” SHPK dhe operatorit ekonomik “Eljona Hoxha” PF ku në nenin 1 “Objekti” përcaktohet bashkimi i përkohëshëm i tyre si vijon: “Për paraqitjen e një oferte konkurruese në procedurën e prokurimit të hapur e të thjeshtuar për shërbimin “Menaxhimi Financiar, Testi i Zhvlerësimit dhe IFRS9” dhe në rast suksesi për përmbushjen e këtij objekti, operatorët ekonomikë, shoqëria “Public Accounting Service Union and Trust” SHPK dhe operatorit ekonomik Eljona Hoxha PF bien dakord të bashkojnë dokumentat ligjore, mjetet, kapitalet financiare si dhe asetet e tyre profesionale në kuadrin e një bashkimi të përkohëshëm në një grup të vetëm”. Në nenin 3 “Pjesëmarrja” përcaktohet se:

“Pjesëmarrja në përqindje e operatorëve ekonomik në tenderin e mësipërm ndërmjet tyre do të jetë në raporte: Eljona Hoxha person fizik është pjesëmarrëse në tender me 50 % (pesëdhjetë përqind) dhe në këtë përqindje do të jetë dhe kjo përqindje do të zbatohet dhe për ndarjen e fitimit. “Public Accounting Service Union and Trust” shpk është pjesëmarrëse në tender me 50 % (pesëdhjetë përqind) dhe kjo përqindje do të zbatohet dhe për ndarjen e fitimit”. Ndërsa në nenin 5 “Organizimi i kryerjes së detyrimeve” parashikohet si vijon: “Palët detyrohen që të kryejnë formimin e një stafi për zbatimin e kësaj kontrate, detyrat që do të realizojë secili operator ekonomik si më poshtë: “Public Accounting Service Union and Trust” shpk do të kryejë detyrat për testin e zhvlerësimit, konkretisht do të angazhohen në llogaritjen e vlerës në përdorim për: -parashikimet e flukseve monetare hyrëse nga përdorimi i vazhdueshëm i aktivitetit. - parashikimet e flukseve monetare dalëse që lindin në mënyrë të nevojshme për krijimin e flikseve monetare hyrëse nga përdorimi i vazhduar i aktivitetit dhe që mund të ngarkohen apo të shpërndahen mbi një bazë të arsyeshme dhe të pandryshueshme aktivitetit. - pritshmëritë lidhur me luhatjet e mundshme në vlerën dhe kohën e këtyre flukseve monetare - normën e skontimit, e cila reflekton (i) vlerën në kohën e këtyre flukseve monetare dhe (ii) rreziqet specifike të lidhura me aktivitetin, për të cilin nuk janë rregulluar vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme në datën e testit të zhvlerësimit. Gjithashtu do të kryej analizat e mëposhtme të vlerësimit:

- Analiza e të ardhurave
- Analiza e kostove
- Analiza e kapitalit punues
- Analiza e investimeve kapitale

Operatori ekonomik Eljona Hoxha person fizik do të angazhohet në përmbushjen e kërkesave të SNRF9.

- Në lidhje me huatë dhe instrumentet financiare të KESH sh.a rikualifikimin e vlerës së rregullimit në pasqyrat financiare të konsoliduara sipas kërkesave të SNRF-së 9
- Përllogaritjen e vlerës së drejtë për huatë e reja duke u bazuar në normat e interesit të tregut në momentin fillestar si dhe rregullimet përkatëse për huatë ekzistuese sipas kostos së amortizuar duke përdorur normën e interesit efektiv
- Rishikimin nëse ka ndonjë risk kreditimi të rritur për ndonjë nga instrumentet financiare në pasqyrat financiare duke u bazuar gjithashtu në vitin paraardhës në mënyrë që të përcaktohen humbjet e pritura të huave, llogaritë e arkëtueshme, kreditë për palët e lidhura dhe mjetet monetare dhe ekuivalente të saj duke përdoruar “qasjen e përgjithshme” ose “qasjen e thjeshtuar” në varësi të elementit financiar [...]”
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. 228/2024, datë 14.05.2024, me shitës shoqërinë “Public Accounting Service Union and Trust” shpk dhe blerës Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a me objekt: “Auditim PF 2021 – dorëzimi i raportit paraprak.”, me vlerë 1,377,000 leke pa TVSH, 1,652,400 lekë me TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. 229/2024, datë 21.05.2024, me shitës shoqërinë “Public Accounting Service Union and Trust” shpk dhe blerës Autoriteti Portual Durrës me objekt: “Shërbim test i zhvlerësimit të aseteve të APD”, me vlerë 2,076,000 leke pa

TVSH, 2,491,200 lekë me TVSH. Bashkëlidhur kontratë me nr. Prot. 764, datë 21.03.2024.

- Faturë tatimore shitje elektronike nr. 345/2022, datë 01.08.2022, me shitës shoqërinë “Public Accounting Service Union and Trust” shpk dhe blerës OSHEE Group SHA me objekt: “Auditim PF 2021 40 % sipas nenit 8 të kontratës”, me vlerë 1,633,600 leke pa TVSH, 1,960,320 lekë me TVSH.
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. 447/2022, datë 06.10.2022, me shitës shoqërinë “Public Accounting Service Union and Trust” shpk dhe blerës OSHEE Group SHA me objekt: “Auditim PF 2021 40 % sipas nenit 8 të kontratës”, me vlerë 1,460,100 leke pa TVSH, 1,752,120 lekë me TVSH
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. 36/2024, datë 14.05.2024, me shitës shoqërinë “Eljona Hoxha” PF dhe blerës Furnizuesi i Tregut të Lirë me objekt: “Auditim PF 2021 – dorëzimi i raportit paraprak për FT”, me vlerë 1,377,000 leke pa TVSH, 1,652,400 lekë me TVSH
- Faturë tatimore shitje elektronike nr. 45/2024, datë 21.06.2024, me shitës shoqërinë “Eljona Hoxha” PF dhe blerës OSHEE Group SHA me objekt: “Auditim PF 2021 – dorëzimi i raportit paraprak për FT”, me vlerë 1,225,200 leke pa TVSH, 1,470,240 lekë me TVSH
- Kontratë shërbimi (auditim) dhe anekset e saj, datë 23.09.2022 lidhur ndërmjet shoqërisë OSHEE-GROUP SH.A dhe audituesve ligjorë z. L.K, znj. V. H, znj. I. D, Znj.Eljona Hoxha.

III.1.4. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.5. Neni 41 pika 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, e VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku

shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.7. Referuar shtojcës nr. 8 “Termat e Referencës” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, për projektin me objekt “*Menaxhimi financiar, testi i zhvlerësimit dhe IFRS9*”, rezulton se autoriteti kontraktor kërkon të paraqesë pasqyrat e saj financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF), në zbatim të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit, KESH sha duhet të kontraktojë një vlerësues të pavarur për të kryer testin e zhvlerësimit për aktivet afatgjata materiale më datë 31.12.2023, 31.12.2024, 31.12.2025, si dhe zbatimin e kërkesave SNRF 9 për instrumentet financiare me qëllim raportimin financiar. Objekti dhe qëllimi i shërbimeve ndër të tjera është kryerja e testit të zhvlerësimit për aktivet afatgjata materiale, vlerësimi i huave të dhëna dhe të marra me vlerën e drejtë në momentin fillestar për huatë e reja, llogaritjen e kostos së tyre të amortizuara, si dhe llogaritjen e vlerës së drejtë në momentin e paraqitjes në pasqyrat financiare

në përputhje me standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), vlerësim (analizim dhe impelmentim) për zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të raportimit Financiar (SNRF).

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Deloitte Albania” SHPK për kundërshtimin e kualifikimit të BOE “Public Accounting Service Union and Trust” SHPK dhe operatorit ekonomik “Eljona Hoxha” PF me arsyetimin se nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.3.1 të shtojcës nr. 9, të dokumentave të tenderit, lidhur me përvojën e ngjashme, si dhe nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga BOE “Public Accounting Service Union and Trust” SHPK dhe operatorit ekonomik “Eljona Hoxha” PF, KPP vëren, se operatori ekonomik në përmbushje të kriterit kualifikues lidhur me shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tri) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me vlerë jo më të madhe se 19% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit pikës 2.3.1 të shtojcës nr.9, ka dorëzuar dokumentacionin e listuar në pikën III.1.3 të këtij vendimi. Konkretisht referuar marrëveshjes së dorëzuar për bashkimin e përkohëshëm të shoqërive në këtë procedurë prokurimi, rezulton se operatorët ekonomikë kanë përcaktuar pjesëmarrjen në përqindje në tender “Eljona Hoxha” PF pjesëmarrës me 50 % dhe “Public Accounting Service Union and Trust” SHPK pjesëmarrës me 50 %, si dhe kanë realizuar ndarjen e shërbimeve që do të realizojë secili prej tyre.

Referuar nenit 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”*, KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmime për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për shërbime ligjvënësi në nenin 41, pika 3 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e dëshmime të lëshuara nga enti publik ose me paraqitjen e faturës tatimore të shitjes ku vërtetohet realizimi me sukses i një ose disa kontratave të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të madhe se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës dhe në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin privat mund të përmbushet

me dorëzimin e faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, ku të vërtetohet realizimi i shërbimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të madhe se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërkit të dokumentacionit është brenda periudhës trevjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave.

III.1.8 Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e kualifikimit të BOE “Public Accounting Service Union and Trust” SHPK dhe “Eljona Hoxha” PF, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ky i fundit, porë kjo në rrafshin krahasimor me shërbimet e hartuar nga autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (ku Komisioni për këtë komponent do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohorë 3 vjeçar nga data publikimit të njoftimit të kontratës), komponenti vlerë (lidhet me vlerën e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 pra shërbime të mëparshme të ngjashme ku vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës) si dhe komponentit natyrë e ngjashme (i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe shërbimet e realizuara).

Lidhur me komponentin kohë, Komisioni për këtë komponent do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohorë 3 vjeçar nga data publikimit të njoftimit të kontratës, ku rezulton se data e publikimit të njoftimit të kontratës është data 09.06.2026, rrjedhimisht Komisioni do të marrë në shqyrtim kontratat apo faturat e lëshuara nga data 09.06.2023, konkretisht, Faturë tatimore shitje elektronike nr. 228/2024, datë 14.05.2024, Faturë tatimore shitje elektronike nr. 229/2024, datë 21.05.2024, Faturë tatimore shitje elektronike nr. 36/2024, datë 14.05.2024, Faturë tatimore shitje elektronike nr. 45/2024, datë 21.06.2024.

Lidhur me komponentin e vlerës referuar procedurës së prokurimit objekt ankimi operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka eksperiencë të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, pra në një vlerë jo më të vogël se 1,653,000 lekë pa TVSH. Referuar kontratës së bashkëpunimit operatori ekonomik “Public Accounting Service Union and Trust” SHPK merr përsipër të kryejë 50 % të shërbimeve, operatori ekonomik “Eljona Hoxha” PF merr përsipër të kryejë 50 % të shërbimeve dhe rrjedhimisht edhe komponenti lidhur me përvojën e ngjashme duhet të realizohet nga secili prej anëtarëve të bashkimit në përputhje me përqindjen që do të realizojë secili prej tyre sipas kontratës së bashkëpunimit.

Lidhur me komponentin e ngjashmërisë Komisioni konstaton, se referuar faturave të sipërpërmendura të cilat rezultojnë se plotësojnë komponentin e afatit, pra janë lëshur brenda 3 vitesh nga publikimi i njoftimit të kontratës, rezulton se operatori ekonomik “Public Accounting Service Union and Trust” SHPK dëshmon që ka përvojë në realizimin e auditimit të pasqyrave financiare, shërbimet e zhvlerësimit të aseteve. Gjithahstu, edhe operatori

ekonomik “Eljona Hoxha” PF anëtar i BOE me faturat e dorëzuara dëshmon se ka përvojë të ngjashme në auditim të pasqyrave financiare, duke dëshmuar në këtë mënyrë se ka përvojë të ngjashme me objektin e procedurës objekt ankimi. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur rezulton se shërbimet e realizuara nga secili prej anëtarëve i BOE ka si objekt shërbime të së njëjtës natyrë me ato të kërkuara në procedurën e prokurimit, duke dëshmuar përvojë në ofrimin e shërbimeve të ngjashme, njohuri teknike dhe kapacitetet për realizimin me sukses të kontratës. Akoma më tej, Komisioni gjykon, se kriteri i veçantë i kualifikimit i përcaktuar në pikën 2.3.1 të shtojcës nr. 9 “kriteret e veçanta të kualifikimit”, të dokumentave të tenderit, kërkon që operatori ekonomik të ketë realizuar shërbime të ngjashme dhe jo identike me objektin e procedurës objekt ankimi, të cilat dëshmojnë aftësinë teknike dhe profesionale për realizimin e kontratës dhe konkretisht BOE pjesëmarrës dëshmon se ka përvojë të ngjashme në testin e zhvlerësimit, në auditim të pasqyrave financiare, në planifikim, strukturim, organizim të punës, përcaktimit të metodave të vlerësimit të aplikueshme, përpilim i pasqyrave përmbledhëse të vlerësimit të aktiveve afatgjata materiale, hartimi i raporteve.

Gjithashtu referuar faturave të sipërpërmendura e plotësojnë dhe e tejkalojnë vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor, pra vlerën jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kontratës së procedurës objekt ankimi. Akoma më tej Komisioni gjykon, se kriteri i veçantë i kualifikimit i përcaktuar në pikën 2.3.1 të shtojcës nr. 9, kërkon që operatori ekonomik të ketë realizuar shërbime të ngjashme dhe jo identike me objektin e procedurës objekt ankimi, të cilat dëshmojnë aftësinë teknike dhe profesionale për realizimin e kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Deloitte Albania” SHPK për ekspertizë të posaçme si vijon: *“[...] Duke qenë se objekti i kontratës kërkon njohuri të specializuara në zbatimin praktik të IFRS 9, metodës së kostos së amortizuar, normës efektive të interesit dhe matjes së vlerës së drejtë të instrumenteve financiare, kërkojmë që shqyrtimi i kësaj ankese të mbështetet edhe në ekspertizë teknike financiare, në mënyrë që të vlerësohet nëse referencat e paraqitura nga operatori ekonomik fitues paraprak provojnë realisht përvojë të ngjashme”*, Komisioni thekson, se lidhur me përmbushjen e kriterit të veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të shtojcës nr. 9 të dokumentave të tenderit, Komisioni është shprehur në pikën III.1.6 e në vijim të këtij vendimi.

Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 24 “Thirrja e ekspertëve”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”. ku parashikohet shprehimisht se: *“Nëse gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës Komisioni vlerëson, se për sqarimin e fakteve kërkojnë njohuri të posaçme në fushat e shkencës, teknikës, teknologjisë ose artit, Komisioni mund të urdhërojë marrjen e mendimit të ekspertëve ose kryerjen e ekspertizës në laboratorë të specializuar”*, marrja e mendimit të ekspertëve është lënë nën diskrecionin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “DELOITTE ALBANIA” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-89214-06-08-2026, me objekt: “Menaxhimi Financiar, Testi i Zhvlerësimit dhe IFRS9”, me fond limit 8,700,000.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 19-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “DELOITTE ALBANIA” Shpk.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Donika Daci

Kryetar
Ismail Shehu

